



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 29 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30/03 / 2022

VENDIM

Nr.07, datë 30 /03/2022

PËR

RAPORTIN VJETOR TË VITIT 2021 PËR OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE KONTROLLIN E DIGAVE QË SHFRYTËZOHEN NGA BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.03.2022 mori në shqyrtim Raportin Vjetor për vitin 2021 në lidhje me Shfrytëzimin, Monitorimin dhe Sigurinë e digave të mëdha që shfrytëzohen nga Bashkia Tiranë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ardhur rezultonte se informacioni nuk është i plotë dhe nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi si dhe kërkesave të KKDM të dërguara pranë Bashkisë Tiranë. Konkretisht, në Raportin vjetor të dërguar mungon informacioni për monitorimin e digave të mëdha dhe ujëmbledhësive duke përfshirë rezultatet e këtij monitorimi dhe instrumentat e instaluar (nëse ka), Informacioni për ekipin e sigurisë dhe monitorimit të digave të mëdha, informacion për projektet dhe investimet e kryera në këto diga, informacione për volumet aktuale dhe kurbat e volumeve për ujëmbledhësit e krijuar nga këto diga, informacionin e gjendjes aktuale përmes fotografimit të këtyre digave si dhe informacioni për planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile dhe hartat e përmbajtjeve në rastet e prishjeve të mundshme të digave. Gjithashtu, në raport ka shumë të dhëna të gabuara që nuk përputhen me gjendjen aktuale apo projektet përkatëse. Antarët e pranishëm të KKDM diskutuan në lidhje me këtë Raport duke u bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur, në legjislacionin e mësipërm si dhe në kërkesat e dërguara nga KKDM pranë kësaj Bashkie. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- **Të mos miratojë Raportin Vjetor të vitit 2021** për gjendjen aktuale, shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha që shfrytëzohen nga Bashkia Tiranë
- 2- **Ti kërkojë Bashkisë Tiranë**
 - Të plotësoj dhe të rishikoj Raportin Vjetor të vitit 2021 për gjendjen aktuale, shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e 40 digave të mëdha që shfrytëzohen nga Bashkia Tiranë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e dhëna nga KKDM të përmendura me sipër duke përfshirë informacion për planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile, hartat e përmbajtjeve, ekipin e sigurisë dhe monitorimit të digave të mëdha si dhe situatën aktuale për monitorimin e këtyre digave.
 - Të prezantojë Raportin vjetor të rishikuar dhe situatën aktuale për gjendjen, monitorimin dhe sigurinë e digave në mbledhjen e KKDM të muajit Maj 2022

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

